





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.59/23
Datë: 26.06.23

Duke u bazuar në nenin 26, 27 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas Nenit 11,13,15,16,17,18,35,51 dhe 55 par 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 26.06.2023, mori këtë;

VENDIM

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve Barawind sh.p.k., (blerës), H-Planet, IVICOM Holding GmbH, (shitësit), për marrjen e kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjen e synuar VE Rakova Bara d.o.o.

Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Kontratën për Shitblerje të Aksioneve, të lidhur me datë; 27.03.2023.

Ivicom Holding GmbH, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, e regjistruar në Gjykatën Tregtare të Vjenës, me numër të regjistrimit të biznesit FN 384723 W, me seli në Wiedner Hauptstrasse 76/2/1, 1040 Vjenë, Austri.

H-Planet, rezvoj in inženiring projektov, sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Sllovenisë, e regjistruar në Gjykatën e Sllovenisë, me numër të regjistrimit 876488300 dhe seli në Verovškova ulica SSA, 1000 Ljubjanë. Aktiviteti i ndërmarrjes është konsulencë inxhinierike dhe teknike, aktivitete holding.

Shitësit janë aksionar të Kompanisë. H-Planet 30% të aksioneve në ndërmarrjen (H-Planet Share) dhe Ivicom mbi 70% të aksioneve në ndërmarrjen (Ivicom).

Barawind sh.p.k Beograd, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar sipas ligjeve të Serbisë, e regjistruar në Regjistrin e Subjekteve Tregtare tek Agjencia e Regjistrimeve të Biznesit, me numër e regjistrimit 21887153 dhe me seli të regjistruar në Mihajla nr. 115 e, 11070 Beograd, Serbi, është ndërmarrje e cila është inkuorporuar me qëllimin e vetëm për të marrë kontrollin në kompaninë e synuar nga H-Planeti dhe Lamium Trade.

VE Rakova Bara d.o.o Žagubica, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e organizuar sipas ligjeve të Serbisë, e regjistruar në Regjistrin e Subjekteve Tregtare tek Agjencia e

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Regjistrimeve të Biznesit, me numër të regjistrimit 21680532 dhe adresë në Jug Bogdanova 2, Žagubica, Serbi .

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (*njëqind euro*) dhe Autorizimin për realizimin e përqendrimit në përputhje të nenit 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të udhëzimit Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës, në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (*tre mijë*) Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë: 24.04.2023, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 172/23-01/H për Njoftim të Përqendrimit, përmes Përfaqësuesve Ligjor Z. Fisnik Salihu dhe Z. Kushtrim Palushi nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law L.L.C., lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjen e synuar VE Rakova Bara d.o.o Žagubica nga Barawind sh.p.k., blerës. Ivicom Holding GmbH dhe H-Planet, razvoj in inženiring projektov, d.o.o., shitësit.

Procedurat e ndjekura:

- a. Vlerësimi i Lëndës
- b. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 24.05.2023
- c. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKK-së me datë 11.05.2023
- d. Më datë. 27.03.2023, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve mbi ndërmarrjen e synuar Rakova Bara d.o.o.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c. Ndërmarrjet, H-Planet, Ivicom dhe Lamium Trade me datë 27.03.2023, kanë nënshkruar kontratën lidhur me marrjen e kontrollit mbi Kompaninë e synuar VE Rakova Bara d.o.o.
- d. Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se pjesëmarrësit në përqendrim janë prezent përmes shitjeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i Konkurrencës

H-Planet, Ivicom, Lamium Trade dhe ndërmarrja e Synuar, nuk janë aktive në Kosovë, si dhe nuk kanë rrjet të prodhimit, shpërndarjes dhe shitjes me shumicë të energjisë elektrike në tregun e Republikës së Kosovës. Ndërmarrja e Synuar nuk është ende funksionale, prandaj transaksioni nuk do të forcoj asnjë pozicion dominues.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Sipas praktikës së Komisioni Evropian e cila në përgjithësi nuk bënë dallim mes burimeve të ndryshme të energjisë së përdorur gjatë përcaktimit të tregut për prodhimin e energjisë dhe shitjen me shumicë të saj. Në vend të kësaj, tregu përkatës zakonisht përfshinë të gjitha objektet e prodhimit të energjisë elektrike, pavarësisht nga burimi i energjisë elektrike, si gazi ose burimet e rinovueshme, mirëpo në disa raste Komisioni i BE-së ka konsideruar diferencimin e tregut bazik në kritere specifike, të tilla si prodhimi, llojet e prodhimit p.sh. bërthamore, gazi, era) dhe legjislacioni (tregu i rregulluar kundrejt tregut të pa rregulluar). Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte negative konkurrencë në tregun e Kosovës, po ashtu nuk do të ketë mbivendosje horizontale apo vertikale ndërmjet palëve në tregun përkatës të propozuar, pasi asnjë palë nuk është aktualisht aktiv në këtë treg.

Tregu Relevant - Struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar në Republikën e Kosovës.

Tregu i produktit - tregu për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike si dhe energjisë së rinovueshme.

Tregu gjeografik - pasi që transaksioni me ndërmarrjen e themeluar dhe aktivitete e saj kanë qasje direkte tek konsumatorët në Republikën e Serbisë, i njëjti do të përcaktohet edhe si treg gjeografik.

Tregjet e Prekura -Transaksioni, nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut, pra do ta ruaj pozicionin aktual në tregun relevant në Republikën e Kosovës pasi që, transaksioni realizohet jashtë territorit të Kosovës.

Efektet e konkurrencës, në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Serbisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra nga palët në përqendrim është prezent në Republikën e Kosovës përmes shitjeve. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht, nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se, ky transaksion nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë për arsye se ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun, si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga, Komisioni.


AUTORITETI I KONKURRENCËS
Komisioni

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net